Drejtoria e Përgjithshme Detare.

"Drejtoria e Përgjithshme Detare" është autoriteti përgjegjës për funksionimin e administratës detare, për politikat e zhvillimit të transportit detar dhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit për fushën e detarisë, në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Instalimi i Sistemit LIRT

LRIT (Long Range Identification & Tracking) është sistemi i identifikimit dhe gjurmimit të anijeve në distanca të largëta nga bregu. Funksionimi i këtij sistemi bazohet në shkëmbimin e të dhënave për pozicioni gjeografik të anijes mes aparaturës së instaluar në bordin e anijes dhe satelitit. Lëvizja e anijeve me flamur shqiptar tashmë është e gjurmueshme në kohë reale. Gjithashtu nëpërmjet këtij sistemi Republika e Shqipërisë ka përmbushur detyrimin e saj që buron nga legjislacioni ndërkombëtar në fushën e detarisë dhe i'u ka ardhur në ndihmë kompanive të menaxhimit të anijeve me flamur shqiptar duke eliminuar përfundimisht ndalimet e anijeve me flamur shqiptar në portet e huaja, si rezultat i mungesës së këtij sistemi.

Sistemi LIRT



Kryerja e investimeve për rikonstruksionin e godinës të Drejtorisë së Përgjithshme Detare

Një nga investimet e rradhës,e cila i mundëson ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, subjekteve që veprojnë në fushën e detarisë,me një infrastrukturë cilësore dhe aksesueshme.

Dixhitalizimi dhe indeksimi i regjistrave të Mjeteve të Vogla Lundruese.

Dixhitalizimi i regjistrave është një hap i rëndësishëm pasi informacionet jepen edhe merren në kohë reale duke ofruar edhe shërbime –online për qytetarët.



`

Paisjet Navigacionale

Me qëllim rritjen e sigurisë në monitorimin dhe menaxhimin e trafikut detar është investuar në instalimin një sistem monitorimi vizual i cili do të kryej detektimin dhe lokalizimin e mjeteve lundruese që afrohen në ujërat e brendshme. Ky sistem do duhet të përshtatet me sistemin e radareve në mënyrë që monitorimi nga salla qëndrore të jetë sa më i plotë dhe dhe të ketë një

Rregjistrimi i mjeteve lundruese dhe detarëve.

Gjatë viteve 2018-2019-2020 është rritur numri i mjeteve lundruse të regjistruar.

8 Mjetet lundruse mbi 15m janë regjistruar në vitin 2018, 14 për vitin 2019 dhe 3 mjete në vitin 2020 edhe pse në periudhe pandemie.

189 Mjetet lundruse nën 15m në vitin 2018, 198 për vitin 2019, 130 në vitin 2020 edhe pse në periudhe pandemie.

37 Motorr deti në vitin 2018, 45 për vitin 2019 dhe 39 për vitin 2020 edhe pse në periudhe pandemie.

185 persona janë pajisur me matrikuj të Flotës Tregëtare për vitin 2018, 232 për vitin 2019, 162 për vitin 2020 edhe pse në periudhe pandemie.

544 persona janë pajisur me dëshmi aftësie për drejtimin e mjeteve të vogla lundruese për vitin 2018, 768 viti 2019 dhe 810 për vitin 2020.

20 persona janë pajisur me matrikuj nga kategoria e studentëve për vitin 2018, 37 për vitin 2019, dhe 9 për vitin 2020 edhe pse në periudhe pandemie

21 persona janë pajisur me matrikuj për mjetet detare për vitin 2018, 26 për vitin 2019, 10 për vitin 2020 edhe pse në periudhe pandemie.

`

monitorim si nga radari por edhe të ofrojë mundësinë e pamjes vizuale.

Qendrat e të trajnimit të personave që kërkojnë të paijisen me dëshmi aftësie për mjetet e vogla lundruese skipper dhe jetski.

Qëndrat e trajnimit të cilat ofrojnë kursin e trajnimit për përgatitjen në praktikë dhe teori të kanditatëve të interesuar për t'u paijisur me dëshmi aftësie për drejtimin e mjeteve të vogla lundruese (skipper dhe jetski) janë:

TSTS
ALBMARINE
H.A.G
A.C.A
NEED
SAIL
AMTC
VMTC

Qendrat e trajnimit dhe kualifikimit të detarëve.

Trajnimi dhe kualifikimi i detarëve garanton sigurinë e jetës njerëzore në det, sigurinë detare, efikasitetin e navigimit, mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit detar. Si rezultat i rritjes së kërkesave të detarëve është bërë e mundur rritja e numrit të qendrave të trajnimit të cilat ofrojnë kurse trajnimi dhe kualifikimi për detarët nga 1 qendër në 3.

Qendrat e trajnimit dhe kualifikimit për detarë janë :

TSTS Group

VMTC

AMTC

Përvec trajnimit dhe kualifikimit të detarëve është rritur edhe numri i qendrave të trajnimit të personave që kërkojnë të paijisen me dëshmi aftësie për mjetet e vogla lundruese skipper dhe jetski nga 3 në 8 qendra.



`

Instalimi i VTMIS (Vessel Traffic Monitoring and Information System)

Sistemi i Informimit dhe Monitorimit të Trafikut Detar shërben për monitorimin e

AIS(Automatic Identification System)

Vendi ynë deri ditën e sotme nuk ka një sistem kombëtar AIS. Me asistencën dhe shpenzimet e EMSA (European Maritime

`

trafikut detar në hapësirën detare të RSH ,parandalimin e incidenteve e aksidenteve të mundshme si dhe mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotjet. Ky sistem, në fazën e parë parashikon ngritjen e 4 port VTS (Durrës,Vlorë,Shëngjin dhe Sarandë) te cilat do të monitorojnë portet dhe radat përkatëse, ndërsa VTS Durrës do të jetë edhe Costal VTS i cili do të monitorojë edhe ujrat territoriale të RSH dhe do bashkërendojë informacionet e ardhura nga Port VTS.

Në fazën e parë ky sistem do të funksionojë si INS (Information Navigation Service) dhe në fazat e tjera do të mundësohen edhe dy shërbimet e tjera TOS (Traffic Organisation Service) dhe NAS (Navigation Assistance Service). Ky sistem do të ngrihet në përputhje të plotë me IALA standards Recommendations and Guidelines. Instalimi i këtij sistemi do e barazojë vendin tonë me të gjitha vendet e tjera të rajonit në lidhje me komunikimin dhe shkëmbimin e informacioneve.

Ka përfunduar faza e studimit të fisibilitetit dhe shumë shpejt do vijohet me procedurat e tenderimit për implementimin e sistemit.



AVTMIS (Albanian Vessel Traffic Monitoring and Information System) Feasibility Study

REPUBLIC OF ALBANIA

MINISTRY OF FINANCE AND ECONOMY

MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENERGY - GENERAL MARITIME DIRECTORATE

AVTMIS - Feasibility Study

(Confidential – ver 3.0)

Project: Western Balkans Trade and Transport Facilitation Project – Albania
International Expert (World Bank)

Assignment Title: Feasibility Study (FS) including the best EU practice in implementing a new VTMIS and lessons learned from the neighbouring countries

Tirana, 05th February 2021

Financed by: World Bank

Implemented by: General Maritime Directorate of Albania

Prepared by Nexhat Kapidani - Consultant 1

Safety Agency), DPD ka mundësuar me në fund instalimin e këtij sistemi.

Qëllimi i këtij sistemi kombëtar është mbulimi me të dhëna satelitore dhe monitorimin e të gjithë aktivitetit detar që zhvillohet në ujrat territoriale shqiptare.

Puna për instalimin e këtij sistemi sapo ka filluar, EMSA ka shpallur fituesin e tenderit (Kompani Italiane) dhe para disa ditësh, dy përfaqësues të kompanisë fituese vizituan të gjithë vijën bregdetare shqiptare dhe shumë shpejt do të përgatisin studimin e fisibilitetit për ketë projekt, i cili sigurisht do ti dërgohet EMSA-ës për miratim.

ANGAZHIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME DETARE NË PROJEKTE NDËRKOMBËTARE

`

“MEDEA”

Drejtoria e Përgjithshme Detare është bërë pjesë e projektit “Mediterranean practitoners’ network & capacity building for effective response to emerging security challenges” . Ky projekt ka si qëllim forcimin dhe stabilizimin e sigurisë në vendet e rajonit të Mesdheut dhe Detit të Zi, duke përdorur kërkimin dhe inovacionin si një katalizator për të nxitur bashkëpunimin midis praktikuesve nga disiplina dhe vende të ndryshme.

https://www.medea-project.eu/

“Sustainable development of BLUE economies through higher education and innovation in Western Balkan Countries BLUEWBC”

Drejtoria e Përgjithshme Detare është bërë pjesë e projektit “BLUEWBC”. “BLUEWBC” synon të rrisë aftësinë e IAL-ve në inovacion dhe ndërmarrësi duke synuar konceptin e ekonomisë blu në Mal të Zi dhe Shqipëri përmes mbështetjes së patnerëve Lituania, Norvegjia dhe Kroacia.



“Development of Regional Joint Master Program in Maritime Environmental Protection and Management / MEP&M”.

Drejtoria e Përgjithshme Detare është bërë pjesë e projektit MEP&M. Ky projekt ka si qëllim qëllim parësor mbrojtjen e zonave bregdetare, mbrojtjen e mjedisit detar nga qeveria malazeze dhe nga ajo shqiptare si edhe krijimin e kapaciteteve njërzore për të mbështetur programet e reja Msc në fushën e menaxhimit dhe mbrojties se mjedisit detarë. Gjithashtu, ky projekt ka si qellim të zhvillojë programin rajonal të përbashkët interdisiplinar MSc në gjuhën angleze për studentët dhe profesionistët që kanë të paktën diplomë BSc, për të adresuar nevojat afatgjate specifike për çështjet e mbrojtjes dhe menaxhimit të mjedisit bregdetar detar në Adriatikun e Jugut dhe detit Jon, duke forcuar kështu konkurrencën ndërkombëtare për mbrojtien dhe menaxhimin e mjedisit detarë dhe kërkimor ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë (IAL).

`